

**STATUT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“iGreen Partners (iGP)”**

Ky statut përpilohet nga :

Zamir Dedej, i biri i Kujtim dhe Anthullës, dt/lindjes 4.08.1966, banuese në Tiranë, madhore e me zotësi të plota juridike për të vepruar i cili ka vendosur të krijojë një shoqëri tregëtare, me përgjegjësi të kufizuar konform vullnetit të tij të lirë dhe ligjit nr. 7638 dt 19.11.1992 “Për shoqëritë tregëtare”, ndryshuar në ligjin 9901, 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar në ligjin 129/2014, ligjin nr.9723, datë 03.05.2007, ndryshuar me ligjin nr. 9916, dt 12.05.2008, ligjin nr.92/2012 dhe ligjin nr.8/2015 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit” si dhe ligjeve të tjera në fuqi, si më poshtë, si dhe me aktet e tjera të legjislacionit shqiptar që trajtojnë këto çështje, krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, si vijon:

**KREU I  
KRIJIMI, OBJEKTI DHE EMËRTESA E SHOQËRISË**

Në përputhje me ligjin 7638 dt 19.11. 1992 “Për shoqëritë tregëtare”, ndryshuar në ligjin 9901, 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” i ndryshuar në ligjin 129/2014, ligjin nr.9723, date 03.05.2007, ndryshuar me ligjin nr. 9916, dt 12.05.2008, ligjin nr.92/2012 dhe ligjin nr.8/2015 “Për Q.K.R.”, krijoj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar si vijon:

**NENI 1  
FORMIMI**

Ortaku formon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me nenin 1/3, nenin 3/1, nenin 67, dhe nenit 71 të ligjit Nr 9901 dt. 14/4/2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”.

**NENI 2  
EMRI I SHOQËRISË**

Konform nenit 4/1 ligjit Nr 9901 dt. 14/4/2008 “Për Tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” do te jete **“iGreen Partners (iGP)”SH.P.K.**

**NENI 3  
SELIA E SHOQËRISË**

Selia e shoqërisë tregëtare **“iGreen Partners (iGP)”** sh.p.k, është në qarkun Tiranë, me seli në adresën: Rr. Mujo Ulqinaku, Hyrja 1, apt. 10.

**NENI 4  
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet. Si datë fillestare merret data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë. Me vendim të ortakeve, shoqëria konform nenit 9 të ligjit Nr 9901 dt. 14/4/2008 “Per Tregëtarët dhe shoqëritë tregtare” Shoqëria “**iGreen Partners (iGP)**”shpk, mund të hapi, filiale dhe degë të saj edhe në rrethet e tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

## **NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Veprimtaria e shoqërisë do të përqëndrohet në fushat e më poshtme dhe aktivitete të lidhura me to:

- Zbatimi i “Marrëveshjes së Gjëlber” nga Bashkimi Europian;
- Studime për biodiversitetin (flora, fauna, habitatet) dhe standartizimi i database-ve;
- Raporte të “Vlerësimit të ndikimit në Mjedis (VNM)”;
- Hartim i planeve të menaxhimit/mbarshtrimit për zonat e mbrojtura, pyjet dhe kullotat;
- Hartim i planeve të rehabilitimi dhe planeve të rievitimit;
- Studime për ujrat dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme;
- Menaxhimi i burimeve natyrore dhe mjedisore;
- Vlerësimi i pasurive të paluajtshme në pyje, kullota, toka bujqësore;
- Edukimi mjedisor;
- Modelim peizazhi, fotogrametri, modelime 3D, batimetri;
- Studime për turizmin dhe menaxhimin e siteve turistike;
- Menaxhim dhe ngritje kapacitetesh për zbatimin e projekteve të BE-së.

## **KREU II KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET, PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI**

### **NENI 6 KAPITALI**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njqind) lekë, kontribut i ortakut të vetëm themelues në masën 100%. Kapitali themeltar është i ndarë në 1 kuot, që ka vlerë të barabartë nominale prej 100 lekësh. Asambleja e ortakeve (Ortaku i vetëm) ka të drejtë të bëjë shtesa dhe ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë.

### **NENI 7 KONTRIBUTET**

Kontributi i përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti i takon ortakut të vetëm themelues në masën 100%.

### **NENI 8 FITIMI**

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë i takon ortakut të vetëm themelues në masën 100%.

**NENI 9**  
**TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të transferohen me anë aktesh mes të gjallëve dhe me trashëgimi. Transferimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë nuk i nënshtrohet asnjë lloj kufizimi, në qoftë se ndodh në rast vdekjeje.

Kapitali themeltrat mund të transferohet tek të tretet vetëm pas miratimit nga ana e administratorit të shoqërisë.

**KREU III**  
**MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQËRISË**

**NENI 10**  
**ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

Asambleja e ortakëve (ORTAKU I VETËM) organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ortaku përballon humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij.

**NENI 11**  
**DREJTIMI SHOQËRISË**

Organi më i lartë drejtues i shoqërisë do të jetë Asambleja e Ortakëve (Ortaku i Vetëm). Asambleja e ortakëve mblidhet si rregull një herë në vit, si dhe sa herë që gjykohet e arsyeshme.

**NENI 12**  
**KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË ORTAKËVE**  
**(ORTAKU I VETËM)**

Asambleja e ortakëve (Ortaku i Vetëm) vendos për këto çështje:

- Emëron administratorin e shoqërisë.
- Emëron ekspertet kontabël.
- Miraton bilancin vjetor.
- Vendos për shpërndarjen e dividendit të shoqërisë.
- Miraton ndryshime në statut.
- Nënshkruan kontrata huamarrje, huapërdorje, qiraje, etj, për llogari të shoqërisë.
- Vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltrar deri në kufirin minimal të lejueshëm nga legjislacioni në fuqi.
- Në rast të shpërndarjes së shoqërisë cakton likuidatorin dhe e shkarkon atë kur përfundon likuidimi.
- Vendimet e asamblesë nënshkruhen nga ortaku i vetëm dhe vërtetohen nga noteri.

**NENI 13**  
**ADMINISTRATORI**

Shoqëria do të administrohet nga ortaku i vetëm Z. Zamir Dedej, për një afat 10 vjeçar nga dita e regjistrimit të shoqërisë pranë QKB-së.

## **NENI 14**

### **KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Administratori i shoqërisë emërohet nga ortaku i vetëm, i cili përgjigjet për zbatimin e vendimeve të asamblesë së ortakëve.

Administratori ka këto kompetenca:

- Të kryej drejtimin e shoqërisë.
- Të përpilojë dhe nënshkruajë kontratat dhe aktet juridike që kanë të bëjnë me veprimtarinë e shoqërisë, në rastet e autorizuara nga themeluesi.
- Të krijojë llogari rrjedhëse bankare pranë bankave shqiptare ose të huaja.
- Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.
- Të emëroj nëpunës të rangjeve të ndryshme për veprime të veçanta teknike ose për një kategori të caktuar veprimesh.
- Të bëjë gjithçka tjetër që konsideron të dobishme dhe që është në përputhje me formën e këtij Statuti e të Aktit Themelues si dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, për të arritur qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

## **KREUI IV**

### **LIBRAT E LLOGARISË, BILANCI, FITIMI, SHPËRNDARJA DHE LIKUJDMI**

#### **NENI 15**

##### **LIBRAT**

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabël që kërkon legjislacioni në fuqi dhe këto libra :

- 1- Libri i ortakëve, në të cilin shënohen emrat e plotë të Ortakëve dhe kuotat që secili ka në kapitalin e themelimit të shoqërisë apo gjatë kryerjes së veprimtarisë.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të asamblesë së ortakëve.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të Administratorit
- 4- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve të organit sindikal (në rast se krijohet një i tillë pranë kësaj shoqërie).

#### **NENI 16**

##### **VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, EKSPERTI KONTABËL**

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë financiar mund të fillojë pas regjistrimit të shoqërisë si person juridik dhe do të përfundojë në fund të cdo viti. Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi operacionet e veçanta të hartuara nga administratori miratohen nga asambleja e ortakëve. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

#### **NENI 17**

##### **PËRCAKTIMI I AFATIT TË VEPRIMTARISË**

Përcaktimi i afatit të veprimtarisë së shoqërisë që është përcaktuar në këtë statut, mund të ndryshohet nga asambleja e ortakëve (Ortaku i Vetëm).

## **NENI 18 AKTIVITETI FINANCIAR**

Në çdo mbyllje të çdo viti financiar, administratori bënë inventarin dhe llogarinë vjetore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin, si dhe hartohet një raport me shkrim.

Bilancit i bashkëngjiten:

a. Një situacion mbi garancitë e dhëna nga shoqëria,

b. Një situacion mbi sigurimet e bëra nga shoqëria,

Raporti i administratorëve përfshin gjendjen gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e mundshme që janë zhvilluar nga data e mbylljes së vitit financiar deri në ditën që është hartuar ky raport.

Dokumentet vihen në dispozicion të ekspertëve kontabël të autorizuar, të paktën një muaj para mbledhjes së asamblesë.

Shoqëria tregëtare me qëllim që të bëjë sa më të lehtë dhe më të shpejtë pagesat me të tretët do të hapi një llogari bankare në një nga bankat e shtetit shqipëtar.

Shoqëria do të ketë vulën e saj me emrin e shoqërisë “**iGreen Partners (iGP)**” sh.p.k dhe do të përdoret vetëm nga administrator i shoqërisë ose i autorizuari prej saj.

## **NENI 19 FITIMET**

Fitimet neto të shoqërisë do të konsiderohen fitimet që rezultojnë pas zbritjes nga të ardhurat e të gjitha shpenzimeve që kanë lidhje me aktivitetin e shoqërisë, detyrimet fiskale, shoqërore, dëmet, amortizimet, etj. në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të veçanta financimi.

Përbërja, shumat e përgjithshme, burimet për krijimin e fondit rezervë, përdorimi dhe rregullimi i çdo fondi të veçantë caktohet nga ortakut i vetëm në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Fitimet ndahen sipas neneve 76 dhe 77 të ligjit Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

## **NENI 20 SHPËRBËRJA E SHOQËRISË**

Shoqëria shpërbëhet me kalimin e një afati të caktuar në të ardhmen si pjesë e pandashme e këtij statuti dhe për arsye të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Shoqëria priset dhe me vendim të Asamblesë së ortakëve (Ortakut të Vetëm).

## **NENI 21 RASTET E PAVLEFSHMËRISË**

Rastet e pavlefshmërisë së shoqërisë ose të një akti që ndryshon statutin, si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqërisë behët në përputhje me dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## **NENI 22 PRISHJA E SHOQËRISË**

Kur shoqëria priset ajo kalon në likuidim dhe në këtë rast emërtimit të shoqërisë i shtohet shënimi "Shoqëri në likuidim e sipër". Shoqëria edhe gjatë procesit të likuidimit vazhdon si person juridik deri në përfundimin e procesit të likuidimit. Shpërbërja e shoqërisë është me pasoja ndaj të tretëve vetëm pas publikimit të çregjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

### **NENI 23 LIKUIDUESIT**

Për të përfunduar procesin e likuidimit, Asambleja e Ortakëve emëron një ose disa persona si likuidues, të cilët përfaqësojnë shoqërinë. Likuiduesit përpilojnë bilancin financiar, likuidojnë tek të tretët detyrimet e shoqërisë, shesin aktivet e shoqërisë dhe ndajnë tepricat në dispozicion.

### **NENI 24 PËRFUNDIMI I VEPRIMTARSË SË SHOQËRISË**

Në përfundim të mbylljes së likuidimit, ortakët thirren që të vendosin për bilancin financiar përfundimtar për aktin e rregullshmërisë, për administrimin e tij nga ana e likuiduesit, dhe për heqjen e mandatit të likuiduesit, si dhe për t'u evidentuar mbyllja e likuidimit. Dokumentet e mësipërme miratohen nga Asambleja e Ortakëve.

### **NENI 25 NDARJA E PASURISË SË SHOQËRISË**

Kur shoqëria likuidohet pasuritë që janë vënë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, u kthehen pronarëve.

Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë dhe fondet fillestare ndahen ndërmjet ortakëve në përpjesëtim me kuotat e vëna pasi të jenë likuiduar kreditorët.

### **NENI 26 DISPOZITA TË FUNDIT**

Shoqëria ka të drejtë të punësojë, punonjës që i nevojiten për të ushtruar veprimtarinë e saj. Punësimi bëhet sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin e punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe rregullave të vëna në kontratën e veçantë të punësimit që lidhet midis punëdhënësit e punonjësit.

Të gjitha problemet që do të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të kësaj shoqërie do të zgjidhen sipas rregullave të përcaktuara në statutin dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **NENI 27**

Ky statut firmoset me vullnetin e lirë të ortakut të vetëm themelues.

**THEMELUES**

*Tirane 20.01.2023*

**Zamir DEDEJ**